



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1759 prot.

Roskovec, më 03.03.2025

VENDIM

Nr. 13, datë 28.02.2025

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 77, DATË 23.12.2024 “PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT PËRFUNDIMTAR TË PBA 2025-2027 DHE BUXHETIT TË VITIT 2025”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1 nënpika 1.1 shkronja “b”, nenit 54 shkronja “dh” të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 77, datë 23.12.2024 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2025-2027 dhe buxhetit të vitit 2025”, si dhe shkresave të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale dhe Kulturore Bashkia Roskovec Nr. 1325, datë 18.02.2025 dhe Nr.1326, date 18.02.2025, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 77, datë 23.12.2024 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2025-2027 dhe buxhetit të vitit 2025”,si më poshtë vijon:
 - Numri maksimal i punonjësve të bashkisë, si dhe të njërive administrative e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë për vitin 2025 nga **395 (treqind e nëntëdhjetë e pesë)** punonjës të përhershëm bëhet **397 (treqind e nëntëdhjetë e shtatë)** punonjës të përhershëm. Konkretisht, shtohen në organikën e njësisë shpenzuese Bashkia Roskovec **2 (dy)** punonjës të përhershëm dhe numri maksimal i punonjësve për njësinë shpenzuese Bashkia Roskovec ndryshon nga **184 (njëqind e tetëdhjetë e katër)** bëhet **186 (njëqind e tetëdhjetë e gjashtë)** punonjës të përhershëm.
- Fondi të përballohet nga fondi për pagat dhe sigurimet shoqërore të miratuar për vitin 2025.
- Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Afrim Plaka

